



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Më Prishtinë, më 05 prill 2012  
Nr. ref.: RK218/12

## **ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 86/11**

Parashtruesi

**Milaim Berisha**

**Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të:**

**Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 të datës 1.3.2011.**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z.Milaim Berisha nga Suhareka me banim në Suharekë rr.:Mulla Nura” p.n,të cilin e përfaqëson me autorizim avokati z.Avdullah Robaj nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i final i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 i datës 1.3.2011 ,të cilin pala e ka pranuar sipas pohimit personal me 11 mars 2011,parashtruesi i kërkesës në Gjykatën kushtetuese ka kërkuar gjithashtu vlerësimin Kushtetues të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C. nr. 65/08 i datës 18.07.2008 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr379/08, i datës 01.12.2008

## **Objekti i çështjes**

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me date 28 qershor 2011 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C. nr. 65/08 të datës 18.07.2008,të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr379/08,të datës 01.12.2008 dhe Aktgjykimit i Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 i datës 1.3.2011,me të cilat sipas parashtruesit të kërkesës i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë,dhe në mënyrë të paligjshme i është marrë prona duke iu dhënë tjetërkujt dhe nga gjykata Kushtetuese ka kërkuar anulimin e vendimeve të lartcekura

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në te tekstin e mëtejme Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010(në tekstin e mëtejme referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme i referuar si rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 28 qershor 2011 Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e z.Milaim Berisha nga Suhareka të paraqitur nga përfaqësuesi i tij ,avokati z.Avdullah Robaj nga Prishtina, dhe në sekretariatit e Gjykatës kjo kërkesë u regjistrua me nr KI 86/11
6. Më 17 gusht 2011 me vendimin GJ.R 86/11 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues gjyqtarin Kadri Kryeziu dhe të njëjtën ditë Kryetari i Gjykatës me vendimin KSH, KI 86/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Alltay Suroy (kryesues ) dhe gjyqtarët Snezhana Botushorova e Ivan Cukalovic, në cilësi të anëtarëve të kolegjit

7. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Qarkut në Prizren Gjykatën Komunale në Prizren i dhe përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës ,avokatin z.Avdullah Robaj për regjistrimin e lëndës me 5 Gusht 2011 .
8. Më 11 Gusht 2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigjeje nga Gjykata e Qarkut në Prizren e cila kishte dërguar kopjet e tri Aktgjykimeve të cilat kontestohen nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën .Kushtetuese
9. Me 12 shtator 2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren nëpërmes faksit dokumentin shtesë –vendimin e Komunës së Suharekës nr 360-483/91 të dt. 23.01.1992 i cili ishte pjesë e dosjes së lëndës në këtë Gjykatë.
10. Me 25 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plote për papranueshmëri të kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

11. Parashtruesi i kërkesës z. Milaim Berisha ka qenë në marrëdhënie pune në IGK "Ballkan" me seli pune në Suharekë nga viti 1972 e deri më 14.09.1990 dhe kryente detyrat e punës së Kryepunëtorit kontrollues.
12. Më 13. tetor 1998 IGK "Ballkan" ka shpallur konkurs për ndarjen e 76 banesave të në lagjen "Ballkani" në Suharekë,të ndërtuara me kontributin e punëtorëve të vet .
13. Më 01. gusht 1989 sipas vendimit nr 5842 të IGK " Ballkan" z. Milaim Berisha e fiton të drejtën e shfrytëzimit të banesës në sipërfaqe prej 73.95 m<sup>2</sup> ,duke qenë i ranguar në vendin e nëntë(9) në listën e punëtorëve që u kanë takuar banesat e ndara nga punëdhënësi i tyre.
14. Nga shkresat e lëndës të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese nuk mund të konstatohet fakti nëse z. Milaim Berisha të ketë lidhur kontratë për shfrytëzimin e banesës,ndërsa sipas pohimit tij personal këtë banesën e ka shfrytëzuar i pa penguar deri më datën 29.01.1992..
15. Më 27.09.1990 organi i dhunshëm(masat e përkohshme të asaj kohe) punëdhënës me vendimin nr 6112/9 z. Milaim Berisha i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak se, sipas vendimit kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës .Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se z. Berisha ka bërë ankesë ndaj këtij vendimi
16. Më 23 .01.1992 Sekretariati për Urbanizëm dhe çështje banesore e Komunale i Komunës së Suharekës e ka nxjerrë Aktvendimin nr 360-483/91 me anë të cilit i urdhërohet z. Milaim Berisha që në afat prej 10 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi ta lirojë banesën në të cilën jeton nga të gjithë personat dhe orenditë brenda saj.
17. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhet se ai është marrë në bazë të kërkesës së IGK"Ballkan" dhe duke marrë për bazë faktin se Gjykata e Punës së Bashkuar në

Gjakovë me vendimin nr 203 të dt. 12.10.1989 kishe anuluar vendimet e Këshillit të Punëtorëve nr. 5836 të datës 3.07.1989 dhe të Komisionit për ndarjen e banesave të IGK"Ballkan" të datës 10.07.1989.

18. Në vitin 1993 banesën nga e cila ishte urdhëruar të largohet z. Milaim Berisha e kishte privatizuar z. Jovanovic Zoran nga Suhareka dhe sipas kontratës për shitblerje të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë ov.br.1976/93 ai e kishte fituar edhe të drejtën e pronësisë mbi te.
19. Më 16.11.2006 sipas përfaqësuesit të z. Milaim Berisha avokatit Avdullah Robaj Drejtorati për Çështje Banesore i UNMIKU-ut i njohur si UN –HABITATI me vendimin HPCC/78/2006 ia kishte njohur të drejtën e pronësisë për banesën kontestuese z. Milaim Berisha por në të vërtetë këtë vendim ai në Gjykatën Kushtetuese nuk e kishte prezantuar si provë dhe nuk gjendet fare në shkresat e lëndës të prezantuara së bashku me kërkesën.
20. Më 28 07 .2007. z Zoran Jovanovic ,kishte autorizuar me shkrim z. Agim Demiri Jurist i dipl. Nga Suhareka që në emër të tij në cilësinë e pronarit të banesës të lidhë kontratë shitblerje me znj Valbonë Baralija nga fshati Bukosh ,KK-Suharekë në cilësinë e blerësit të banesës e cila ndodhej ne Suharekë në Lagjen Fidanishte ,banesa nr 8,ndërtesa 3 ,kati i dytë me sipërfaqe prej 73.95 m<sup>2</sup>.
21. Më 30.08.2007 ,kjo kontratë e lidhur dhe e nënshkruar në mes palëve kontraktuese z. Agim Demiri si përfaqësues i z, Zoran Jovanovic dhe znj. Valbonë Baraliju, është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë dhe në Drejtorinë për Ekonomi e Financa të Komunës së Suharekës është paguar ngarkesa financiare për kompensimin lidhur me transferimin e pasurisë së patundshme në vlerën prej 200.00€.
22. Më 8 tetor 2007 Drejtorati për Çështje banesore i UNMIK-ut në Prishtinë i kishte dërguar një shkresë Kryetarit të Gjykatës Komunale në Suharekë dhe Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren që në këtë drejtorat gjendet në procedurë ankesa e z. Milaim Berisha lidhur me një kontest banesor e cila si palë kundërshtare ka z, Zoran Jovanovic dhe se këtyre dy gjykatave u ndalohet vërtetimi i çfarëdo kontrate lidhur me këtë patundshmëri përpos nëse palët në kontest z,Milaim Berisha e z. Zoran Jovanovic do të arrinin pajtueshmëri në mes tyre lidhur me atë kontratë.
23. Kjo kërkesë nga kjo drejtori ishte dërguar Gjykatave me 8 tetor 2007 por në fakt një kontratë shitblerje në mes të z. Zoran Jovanovic i përfaqësuar nga z. Agim Demiri në cilësi të shitësit dhe zonjës Valbonë Baraliju në cilësinë e blerësit të banesës kontestuese tashmë ishte lidhur dhe vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë me 30 gusht 2007 dhe sipas shkresave të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese kjo kontratë asnjëherë nuk është anuluar.
24. Më 18.07.2008 duke vepruar sipas kërkesëpadisë së z. Valbonë Baraliju ,Gjykata Komunale në Suharekë ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.65/2008 me anë të së cilës APROVON kërkesëpadinë e z, Baraliju dhe DETYRON z, Milaim Berisha që në afat prej 15 ditësh t`ia dorëzojë pronën e paluajtshme-banesën që gjendet në lagjen Fidanishte në Suharekë znj Valbonë Baraliju e cila është pronare e kësaj banese sipas kontratës për shitblerje të vërtetuar n Gjykatën Komunale në Suharekë me nr.VR.nr 2871/07 të datës 30.08.2007.

25. Më 01.12.2008 Gjykata e Qarkut në Prizren ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të z. Milaim Berisha dhe kishte lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Suharekë C.nr.65/08 .
26. Më 1.3.2011 Gjykata Supreme e Kosovës ka **Refuzuar** si të pabazuar Revizionin e të Paditurit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.379/2008 të datës 1.12.2008 dhe përfundimisht pronare të ligjshme të palujtshmërisë-banesës kontestuese e kishte caktuar znj. Valbonë Baraliu.
27. Përfundimisht duke qenë i pakënaqur me Aktgjytimeve Gjykatave kompetente z. Milaim Berisha ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 28.06.2001 duke kërkuar shfuqizimin e të gjitha Aktgjytimeve dhe deklarimin e tyre si jo Kushtetuese e të paligjshme.

### **Pretendimet e parashtruesit**

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimet e cekura më lartë të Gjykatës Komonale në Suharekë, asaj të Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës ,asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe atë me nenin 21 al.1,2,3 e 4 ,:nenin 31 al 1 e 2 dhe në mënyrë të veçantë me nenin 46(mbrojtja e pronës. )
29. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Komonale në Suharekë duke vërtetuar kontratën për shitblerje në mes të palëve kontraktuese z.Jovanovic Zoran në cilësinë e shitësit dhe znj.Valbonë Baraliu në cilësinë e blerësit me datë 30.8.2007 në fakt ka bërë një punë juridike të paligjshme sepse ka legjitimuar si pronar të banesës e cila ishte objekt i kësaj kontrate z. Jovanovic edhe pse në fakt pronar i vërtetë është z. Milaim Berisha i cili kishte të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese që nga viti 1989. Ndërsa Gjykata Komonale në Suharekë duke aprovuar si të bazuar padinë e paditëses Valbonë Baraliu me të cilën obligohet z.Berisha si i paditur, t`ia dorëzojë banesën në pronësi dhe Gjykata e qarkut e Gjykata Supreme duke refuzuar ankesën gjegjësisht revizion e z, Berisha vetëm se e kanë përsëritur vendimin e gabuar të Gjykatës Komonale duke e privuar atë nga gëzimi i të drejtës së pronës në banesën kontestuese.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

30. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetutë,Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese
31. Ne lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

**"Individët janë te autorizuar te ngrenë shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi te kenë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj."**

32. Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

33. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Gjykata kushtetuese dhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkalës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

34. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet se parashtruesi i sajë ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe në fakt asnjëra nga Gjykatat e rregullta nuk i ka dhënë të drejtë në pretendimet e tij ,andaj Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se Gjykatave të rregullta gjate ekzaminimit te rastit, ju mungonte paanshmëria ose qe procedura ishte e padrejte.

35. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij duke sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, apo nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutë.

36. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve të veta me atë të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si është marrë prova.( shih Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar, Aktgjykimi GJEDNJ App. br 13071/87 par 34, dt. 10. korrik 1991. ).

37. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë te pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë te ngrenë një kërkesë te argumentueshme për shkelje te Nenit 31 te Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kunder Hungarise, Aktgjykim i 26 korrikut 2005

38. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij dhe as shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës(e drejta e pronës)sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë se Gjykatat e



rregullta të tri shkallëve ti kenë mohuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ,andaj nuk konsiderohet që parashtruesi ka përmbushur kërkesat e sipërpërmendura për marrjen e vendimit për pranueshmëri, dhe kërkesa është e papranueshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës ,nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores më 25 nëntor 2011 njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Kadri Kryeziu



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani